



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 01.12.2022

Nr: 218

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**MIRATIMIN E PROGRAMIT PËR TRAJNIMIN DHE MONITORIMIN E ADMINISTRATËS
ZGJEDHORE DHE TË DISA AKTORËVE TË TJERË PËR ZGJEDHJET E ORGANEVE TË QEVERISJES
VENDORE**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “b” e “gj”, e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

VENDOS:

1. Miratimin e programit për trajnimin dhe monitorimin e administratës zgjedhore dhe të disa aktorëve të tjerë, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të 14 majit 2023, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 01.12.2022 Nr: 218
Ora: 11:00



“Për miratimin e programit për trajnimin dhe monitorimin e administratës zgjedhore dhe të disa aktorëve të tjerë për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore”

PROGRAMI
PËR
TRAJNIMIN DHE MONITORIMIN E ADMINISTRATËS ZGJEDHORE DHE TË DISA AKTORËVE TË
TJERË PËR ZGJEDHJET E ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE

I. Qëllimi dhe parimet

1. Trajnimet e administratës zgjedhore dhe aktorëve të tjerë të përfshirë në zgjedhje organizohen nga KQZ, përmes trajnerëve të rekrutuar prej saj.
2. Trajnerët do të trajnohen nga KQZ me module për administratën zgjedhore dhe disa aktorë të tjerë që do të përfshihen në procesin zgjedhor si monitoruesit e fushatës zgjedhore, kandidatët e subjekteve politike si dhe administrata publike e pushtetit vendor.
3. Organizimi i trajnimeve udhëhiqet nga parimi i transparencës, meritokracisë dhe trajtimit të barabartë për situata objektive të njëjta.

II. Metodologjia e realizimit të trajnimeve

1. Metoda e trajnimit "Kaskadë" dhe "ekipe të lëvizshme" përfshin dy shkallë:
 - a) Shkalla e parë përfshin trajnimin e kandidatëve për trajnerë të administratës zgjedhore. Kandidatët për trajnerë do të trajnohen nga trajnerë profesionistë të cilët kontraktohen nga KQZ.
 - b) Shkalla e dytë përfshin trajnimin e administratës zgjedhore KZAZ, KQV, GNV. Administrata zgjedhore trajnohet nga trajnerët në nivel njësie vendore (Bashki) dhe/ose njësie administrative, sipas skemës analitike për secilin nivel të komisionerëve zgjedhorë (KZAZ, KQV, GNV). Ky grup trajnerësh do të jetë i lëvizshëm dhe do të mbulojë zona/ njësi administrative të ndryshme duke dhënë trajnime për administratën e nivelit të tretë pranë njësive të tyre administrative.
2. Drejtoria e administratës zgjedhore (DAZ), përmes sektorit të dokumentacionit zgjedhor dhe trajnimeve (SDZT), koordinon trajnimin e trajnerëve të administratës zgjedhore dhe të administratës zgjedhore.

III. Sektori i dokumentacionit zgjedhor dhe trajnimeve

1. DAZ përmes SDZT zbaton parashikimet e përcaktuara në këtë akt dhe kryen, në funksion të trajnimeve, këto detyra:
 - a) Angazhohet për përzgjedhjen e trajnerëve profesionistë dhe të trajnerëve të administratës zgjedhore si dhe harton skemën e zhvillimit të trajnimeve apo edhe kalendarin rezervë sipas nevojave. Trupa e trajnerëve që do të angazhohen në zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të 14 majit 2023 do të jetë 79 nga të cilët 39 trajnerë afatgjatë dhe 39 trajnerë afatshkurtër.
 - b) Propozon zgjidhje të cilat tejkalojnë parashikimet në këtë akt për problematikat e shfaqura në periudhën zgjedhore, brenda parashikimeve buxhetore të KQZ.

- c) Harton modulet e trajnimeve, modelet e pyetësorëve për vlerësimin e trajnimeve apo modelet e raportimeve.
 - d) Administron raportet përfundimtare të trajnerëve, për administratën zgjedhore.
 - e) Harton materiale ndihmëse në funksion të trajnimeve të administratës zgjedhore.
 - f) Koordinon, në bashkëpunim me strukturat e tjera në KQZ, angazhimin e trajnerëve të administratës zgjedhore në trajnimin e punonjësve të administratës së pushtetit qendror e vendor, monitoruesve të fushatës zgjedhore, kandidatëve të subjekteve politike.
 - g) Vlerëson nevojën e rishikimit të moduleve ekzistente apo moduleve të reja dhe angazhon trajnerët profesionistë për rishikimin apo hartimin e tyre.
2. SDZT u kërkon bashkive për të përcaktuar mjediset e përqendruara si dhe mjediset e tjera të nevojshme për zhvillimin e trajnimeve, sipas afateve të përcaktuara dhe standardeve e kritereve logjistike, për organizimin e trajnimeve. Në rast se bashkitë nuk mundën të ofrojnë mjediset e përqendruara, trajnimi të zhvillohet në mjedise që bashkitë propozojnë. Në rast se këto mjedise nuk plotësojnë kriteret, KQZ merr mjedise me qera (mundësisht në objekte publike) për organizimin e trajnimeve.
 3. Në funksion të zbatimit të detyrave operacionale për realizimin e trajnimeve të administratës zgjedhore, sekretari i përgjithshëm shqyrton dhe miraton aktet apo dokumentacionin e vënë në dispozicion të tij nga DAZ.

IV. Kriteret e rekrutimit të kandidatëve për trajnerë të administratës zgjedhore

1. Kriteret profesionale që duhet të përmbushë kandidati që aplikon për trajner janë:
 - a) formimi universitar i ciklit të parë apo të dytë sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në fushën e përcaktuar në njoftimin për shprehjen e interesit të publikuar nga KQZ në faqen zyrtare të saj;
 - b) përvojë në mësimdhënie në institucionet e arsimit të lartë apo në institucionet parauniversitare të arsimit parauniversitar, apo i angazhuar si trajner nga organizatat e njohura vendase apo ndërkombëtare, mundësisht me një eksperiencë si trajner në proceset zgjedhore të mëparshme;
 - c) Trajnerët profesionistë duhet të kenë formim universitar së paku të ciklit të dytë dhe të kenë një përvojë në mësimdhënie jo më pak se 10 vjet në institucionet e arsimit të lartë apo të angazhuar si trajner nga organizatat e njohura vendase apo ndërkombëtare, mundësisht me një eksperiencë si trajner në proceset zgjedhore të mëparshme;
2. Kandidati për trajner, për të mos kompromentuar procesin e trajnimit duhet:
 - a) Të jetë i paangazhuar në struktura drejtuese qendrore e vendore të partive politike dhe të mos ketë patur aktivitete të deklaruar publik në fushatë zgjedhore ose aktivitetin politik të një subjekti zgjedhor
 - b) Të mos jetë në detyrë në strukturat e organeve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, inspektorati qendror apo lokal, ushtarak aktiv i Forcave të Armatosura, punonjës i Shërbimit Informativ, organeve të pushtetit gjyqësor;

- c) Të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
 - d) Të mos jetë i dënuar administrativisht për shkelje të dispozitave, të cilat lidhen me zgjedhjet, apo të mos ketë masë disiplinore në fuqi në shërbimin civil;
 - e) Preferohen kandidatët të cilët janë banorë të bashkisë/njesisë administrative në të cilën aplikojnë.
3. Në thirrjen për aplikim përcaktohen dokumentet, vërtetimet apo deklaratimet që kandidatët duhet të depozitojnë në aplikimin e tyre.

V. Procedurat për aplikimin e kandidatëve për trajnerë të administratës zgjedhore

1. KQZ, për rekrutimin e trajnerëve të administratës zgjedhore, publikon në faqen e saj zyrtare të internetit “thirrje për aplikim”.
2. Thirrja për aplikim specifikon llojin e trajnerit që KQZ ka nevojë. Ka tre lloje trajnerësh:
 - a) Trajner profesionist
 - b) Trajner afatgjatë
 - c) Trajner afatshkurtër
3. Trajneri profesionist angazhohet për trajnimin e trajnerëve, hartimin e moduleve apo në mësimdhënie video regjistrim përmes platformës e-learning sipas kërkesave të KQZ.
4. Trajneri afatgjatë angazhohet me trajnimin e
 - a) administratës zgjedhore
 - b) punonjësve të administratës së pushtetit vendor
 - c) monitoruesve të fushatës zgjedhore
 - d) kandidatëve të subjekteve politike
 - e) monitorimin e administratës zgjedhore
5. Trajneri afatshkurtër angazhohet me trajnimin e:
 - a) administratës zgjedhore
 - b) kandidatëve të subjekteve politike
 - c) monitorimin e administratës zgjedhore
6. Afati në thirrjen për aplikim të lihet jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi i thirrjes.
7. Thirrja për aplikim të përmbajë informacionin e mëposhtëm:
 - a) Numrin e trajnerëve që KQZ ka nevojë sipas bashkive;
 - b) Fazat e vlerësimit për t’u bërë trajner;
 - c) Profilin/fushën e studimit si dhe njësinë administrative/bashkinë/qarkun për të cilat është hapur thirrja;
 - d) Informacion mbi shërbimin e kërkuar;
 - e) Kriteret dhe dokumentacionin e nevojshëm të aplikantit;
 - f) Mënyrën e aplikimit dhe afatet e aplikimit.
8. Aplikimet të bëhen online në linkun përkatës të publikuar nga KQZ në faqen e saj zyrtare.

VI. Vlerësimi i aplikimeve të kandidatëve për trajnerë të administratës zgjedhore

1. Dosjet e aplikantëve, kandidatë për trajnerë, si dhe dokumentacioni i tyre shqyrtohen nga DAZ brenda 7(shtatë) ditëve nga dita e fundit për depozitimin e aplikimeve.
2. Aplikimet e kandidatëve që përmbushin kriteret dhe disponojnë dokumentacionin përkatës kualifikohen nga KQZ edhe pse numri i aplikimeve mund të jetë më i madh se nevoja që KQZ ka deklaruar.
3. KQZ përmes DAZ, pikëzon, dosjet e aplikantëve dhe i rankon ato duke filluar me kandidatin me më shumë pikë dhe vijuar me rend zbritës, të ndarë për çdo bashki.
4. Pikëzimi i aplikimeve mbështetet në nivelin e diplomës, përvojën në mësimdhënie në institucionet e arsimit të lartë apo në institucionet parauniversitare të arsimit parauniversitar, eksperiencën në fushën e trajnimit, eksperiencën e tyre në trajnimin me të rriturit, eksperiencën të suksesshme të mëparshme në procese zgjedhore.
5. KQZ trajnon kandidatët për trajnerë në jo më pak se 5% se numri i nevojshëm që do të angazhohen në procesin zgjedhor por në çdo rast numri i përfshirë do të jetë brenda planifikimit buxhetor të miratuar për këtë qëllim.
6. KQZ, përmes SDZT, njofton elektronikisht aplikantët për trajnimin që duhet të kryejnë.
7. Pjesëmarrja e rregullt në trajnim është e detyrueshme.
8. KQZ në angazhimin e trajnerëve respekton listën e rankimit.
9. Kur për shkaqe të ndryshme, numri i kandidatëve për trajnerë është nën numrin e nevojshëm të kërkuar nga KQZ, SDZT plotëson numrin e nevojshëm duke iu referuar rankimit të kryer. Kandidatët njoftohen për të kryer një trajnim të përshpejtuar vetëm mbi tematikën për të cilën ata do të angazhohen. Pas shterimit të kësaj liste, sektori i trajnimeve, për plotësimin e numrit të nevojshëm i referohet regjistrit të trajnerëve të viteve të mëparshme. Në të gjitha rrethanat edhe këta trajnerë duhet të kryejnë trajnimin.

VII. Trajnimi i kandidatëve për trajnerë

1. Trajnimi i kandidatëve për trajnerë kryhet në KQZ apo në mjedise të përcaktuara nga KQZ për këtë qëllim, fizikisht ose online. Si rregull ato kryhen nga trajnerët profesionistë të cilët kontrahohen nga KQZ.
2. Trajnimi organizohet në sesione. Çdo sesion për trajnimin e trajnerëve të administratës zgjedhore zgjat 3 orë. Në çdo ditë zhvillohen jo më shumë se dy sesione.
3. Trajnimi i kandidatëve për trajnerë do të organizohet me ndarjen e tyre në grupe.
4. Kohëzgjatja e trajnimit për çdo grup trajnimit për trajnerët afatgjatë është 24 orë të shpërndara në 4 ditë, ndërsa trajnimi i trajnerëve afatshkurtër është 12 orë, e shtrirë në 2 ditë.
5. Kandidatët për trajnerë trajnohen lidhur me administratën zgjedhore, monitoruesit, kandidatët e subjekteve zgjedhore dhe me detyrimet e administratës publike qendrore e lokale në funksion të procesit zgjedhor.

6. Kandidatët për trajnerë përgjatë trajnimit vlerësohen maksimalisht me 70 pikë për aktivizimin e tyre, prezantimet dhe punët e kryera dhe me 30 pikë për testimin me shkrim.
7. Trajnimi konsiderohet i kaluar me sukses kur kandidati vlerësohet me së paku 70% të pikëve për aktivizimin e tyre, prezantimet dhe punët e kryera si dhe 50% të pikëve të testimit me shkrim. Kandidatët që kalojnë me sukses trajnimin, bëhen pjesë e bazës së të dhënave në KQZ.
8. Sektori i trajnimeve, duke respektuar renditjen, komunikon me trajnerët përkatës, sipas nevojës për trajnerë/për bashki dhe i njofton ata për të nënshkruar kontratën.
9. Trajnerët profesionistë nuk i nënshtrohen trajnimit dhe testimit, por vlerësohen mbi bazën e një interviste të strukturuar nga DAZ.
10. DAZ vlerëson nëse trajnimi mund të realizohet i drejtpërdrejtë sipas kërkesave në kushte normale, trajnim online apo i kombinuar.
11. KQZ, brenda mundësive merr masa për trajnimin e administratës zgjedhore të zëvendësuar apo vendos në dispozicion të tyre materiale lehtësuese trajnuese.

VIII. Detyrat e trajnerëve

1. Për trajnimin e administratës zgjedhore, trajneri i kontraktuar nga KQZ
 - a) Respekton përcaktimet dhe urdhërimet e KQZ. Ai do të kryejë trajnimet në mjediset e qendrave të trajnimeve të cilat do të jenë të disponueshme, sipas një kalendarit të hartuar nga vetë trajneri, përgjatë periudhës së përcaktuar nga KQZ për kryerjen e trajnimeve.
 - b) Për trajnimin e KQV, trajneri koordinon me KZAZ përkatëse dhe në bashkërendim me to, përcakton oraret e trajnimeve për komisionerët e qendrave të votimit.
 - c) Trajneri do të hartojë planin e trajnimit ku përcaktohet vendi, orari dhe të dhëna mbi anëtarët e KZAZ-ve, KQV-ve apo GNV-ve që do trajnojnë, sipas qendrave të caktuara nga KQZ.
 - d) Plani i trajnimit i dërgohet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe në rast se KQZ nuk e refuzon atë brenda 24 orëve, atëherë plani i trajnimit konsiderohet i miratuar.
 - e) Koha/orari i planifikuar për zhvillimin e trajnimeve duhet të jetë fleksibël duke bërë që anëtarët e KQV-ve apo GNV-ve, të kenë mundësi zgjedhjeje për ndjekjen e trajnimeve.
 - f) Plani i trajnimit, për aq sa është e mundur, të organizohet në mënyrë të tillë që kryetarët dhe sekretarët të grupohen bashkë.
 - g) Trajneri zhvillon trajnimin vetëm nëse prezent janë jo më pak se 5 persona.
2. Trajneri do të kryejë detyra monitoruese të veprimtarisë së administratës zgjedhore të trajnuar nga vetë ata si dhe qendrat e votimit apo mjediset e KZAZ-ve për plotësimin e kushteve në të cilat administrata zgjedhore kryen detyrat e saj.
 - a) Monitorimi do të kryhet vetëm me kërkesë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe në bazë të planifikimit të detyrave nga struktura përkatëse.

- b) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të pajisë trajnerët me dokumentin përkatës për ushtrimin e detyrës së tyre sipas këtij funksioni.
3. Raportimi i trajnerëve të administratës zgjedhore
- a) Të gjithë trajnerët, për çdo trajnim të kryer, sipas planit të trajnimit, raportojnë online, periodikisht, në kohë reale në KQZ, përmes linkut që KQZ u dërgon atyre ose në mungesë të tij, në mediumet e komunikimit elektronik.
- b) Pas përfundimit të procesit të trajnimit me të trajnuarit respektivë sipas planit të trajnimeve, trajnerët hartojnë raportin përfundimtar.
- DAZ vlerëson raportin përfundimtar të trajnerit dhe mbi bazën e tij dhe dokumentacionit shoqërues bën përlllogaritjen e angazhimit të trajnerit.
4. Detyra të tjera të trajnerëve
- a) Trajnerët që do të trajnojnë monitoruesit e fushatës zgjedhore, administratën publike të pushtetit vendor si dhe kandidatët e partive politike do të trajnohen me modulet përkatëse nga KQZ.
- b) Trajnimi i monitoruesve të fushatës zgjedhore dhe trajnimi i administratës publike të qeverisjes vendore do të kryhet në nivel qarku.
- c) Trajnimi i monitoruesve konsiston në njohjen nga ana e tyre të respektimit lehtësisht të verifikueshëm të detyrimeve të subjekteve zgjedhore apo kandidatëve për fushatën zgjedhore, ndalimeve dhe kufizimeve të formave të caktuara të fushatës, përdorimin e materialeve propagandistike, ngritjen dhe veprimtarinë në zyrat zgjedhore, ndalimet dhe kufizimet për veprimtari të caktuara para ditës së zgjedhjeve, përdorimin/shpërdorimin e burimeve shtetërore si dhe raportimin e gjetjeve të tyre.
- d) Trajnimi i administratës publike të qeverisjes vendore konsiston në njohjen nga ana e kësaj administrate të konceptit të veprimtarisë publike si dhe kategoritë e veprimtarive publike të ndaluara dhe detyrimin e administratës për të mos kontribuar në çfarëdo formë në veprimtaritë e ndaluara, të drejtat dhe detyrimet e punonjësit të administratës publike gjatë periudhës zgjedhore . Trajnimi konsiston edhe në njohjen me ndërfaqen e raportimeve, procedurat që ndiqen apo afatet e raportimit të administratës publike të pushtetit vendor si dhe sanksionet administrative të përcaktuara.
- e) Në trajnimin e kandidatëve të subjekteve zgjedhore do të përfshihen edhe trajnerët e rekrutuar për një periudhë afatshkurtër, pasi më parë të jenë trajnuar nga KQZ. Trajnimi i kandidatëve të subjekteve zgjedhore për kryetar të bashkisë apo anëtarë të të këshillit të bashkisë trajnohen për raportimin e shpenzimeve të fushatës zgjedhore.
- f) Kalendari, vendi, orari dhe organizimi i trajnimit të monitoruesve të fushatës zgjedhore, të administratës publike të pushteti vendor apo të kandidatëve të subjekteve zgjedhore do të realizohet nga KQZ, përkatësisht nga Drejtoria e subjekteve zgjedhore, mbikëqyrjes, financimit dhe monitorimit (DSZMFM).

IX. Aspekte financiare

1. KQZ lidh kontratë shërbimi me trajnerët profesionistë që do të angazhohen në trajnimin e trajnerëve të administratës zgjedhore. Vlera e pagesës për orë trajnimi për trajnerët profesionistë është 1500 (njëmijë e pesëqind) lekë për trajnimin e trajnerëve të administratës zgjedhore sipas përcaktimeve në këtë akt, apo në mësimdhënie video regjistrim përmes platformës e-learning sipas kërkesave të KQZ.
2. Masa e pagesës së plotë për hartimin e kurrikulave apo të materialeve të trajnimit nga trajnerët profesionistë, të nevojshme për zhvillimin e 6 orëve 60-minutëshe trajnimi të jetë 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë, ndërsa për më pak se 6 orë pagesa të llogaritet në përpjesëtim me çmimin për orë trajnimi. Rishikimi i materialeve ekzistente të KQZ ka një vlerë deri në 50% të pagesës së plotë. Hartimi i materialeve të tilla bëhet me kërkesë të KQZ.
3. Për zhvillimin e trajnimeve dhe përmbushjen e detyrave të trajnerit, KQZ lidh me trajnerin kontratën individuale të shërbimit.
4. Në kontratë parashikohet pagesa si trajner i administratës zgjedhore, në bazë të orëve të realizuara si dhe pagesa si monitorues i performancës së administratës zgjedhore dhe verifikimit të qendrave të votimit.
5. Kohëzgjatja e trajnimit do të jetë 2 orë për anëtarët e KZAZ, GNV apo KQV ndërsa për kryetarë dhe sekretarë të KQV-ve 4 orë.
6. Vlera e pagesës për një orë trajnimi për kategorinë e trajnerëve është 750 (shtatëqind e pesëdhjetë) lekë, ndërsa për një orë monitorimi është 300 (tremijë) lekë.
7. Në rastet kur trajneri nuk kryen trajnimin për shkak të mungesës së numrit minimal të pjesëmarrësve të kërkuar, pagesa e tij do të jetë 300 lekë. Ky parashikim vlen vetëm për zonat e riskut.
8. Trajneri paguhet edhe për realizimin e trajnimeve të tjera me administratën e pushtetit qendror a vendor, kandidatëve të subjekteve politike apo monitoruesve të fushatës zgjedhore sipas programit të hartuar nga drejtoritë që mbulojnë këto çështje dhe të miratuar nga KQZ.
9. Pagesa e trajnerit kryhet pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga ai në KQZ për përmbushjen e realizimit të numrit total të orëve dhe detyrimeve të tjera.
10. Trajnerët, në përfundim të të gjithë trajnimeve, sipas planit të trajnimit, dorëzojnë në KQZ:
 - a) Planin e trajnimit;
 - b) Raportet përkatëse të zhvillimit të çdo trajnimi sipas formateve tip të dërguara nga KQZ;
 - c) Listprezencën e nënshkruar nga pjesëmarrësit në çdo trajnim të kryer;
 - d) Fletëtestimet e pjesëmarrësve (vetëm për KZAZ);
 - e) Raportin përfundimtar.
11. Përmbushja e detyrimeve të trajnerëve për trajnimin e monitoruesve të fushatës zgjedhore, kandidatëve, administratës së pushtetit vendor dhe përlllogaritja e aspekteve financiare të këtyre trajnimeve ndiqet dhe analizohet nga DSZMFM.

X. Monitorimi i trajnimeve nga KQZ

1. Monitorimi i vlerësimit të trajnimeve të administratës zgjedhore bazohet në planin e trajnimeve që trajnerët kanë depozituar në KQZ.
2. DAZ i propozon Sekretarit të Përgjithshëm listën e vendndodhjeve që vlerëson, që duhet monitoruar sipas një përzgjedhje rastësore apo në bazë të problematikave të raportuara dhe, pas miratimit tij, ushtron monitorimin në vendin e përcaktuar.
3. Grupet monitoruese hartojnë raportet e monitorimit të cilat depozitohen tek Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së.
4. KQZ ndërpret kontratën me trajnerët e çdo kategorie nëse ai:
 - a) zhvillon module trajnimi që nuk përkojnë me atë të miratuar nga KQZ;
 - b) nuk respekton normat dhe rregullat e etikës;
 - c) nuk përdor materialet e trajnimit për zhvillimin e modulit;
 - d) nuk njofton ndryshimin e planit të trajnimit;
 - e) nuk paraqitet në vendin e trajnimit, sipas kalendarit të njoftuar.
5. KQZ mbledh gjatë monitorimeve praktikat e suksesshme, të cilat i shërbejnë për përmirësimin e punës në vijim.

XI. Vlerësimi i trajnimeve

1. KQZ, për rritjen e cilësisë së trajnimeve, përcakton treguesit e performancës së trajnimit.
2. Treguesit e performancës sigurohen nga monitorimi i drejtpërdrejtë, nga informacioni i dërguar nga trajnerët në kohë reale dhe raporti përfundimtar, duke identifikuar:
 - a) Përqindjen e realizimit të planit të trajnimit duke analizuar përqindjen e prezencës së pjesëmarrësve në trajnim;
 - b) Përqindjen e kalueshmërisë së pjesëmarrësve në trajnim;
 - c) Përgatitjen e informacioneve në kohë reale dhe raportit përfundimtar;
 - d) Rezultatet e verifikimit paszgjedhor që dëshmojnë për mangësi domethënëse të respektimit të kërkesave të KQZ.
3. Cilësia e trajnimit do të evidentohet nga KQZ përmes monitorimeve të saj apo përmes shpërndarjes së sa më shumë pyetësorëve në administratën zgjedhore.
4. Treguesit e performancës së trajnuesit do të shërbejnë për vlerësimin e trajnerit në angazhimet e mëvonshme dhe kryesisht për përmirësimin në vazhdimësi të procesit të trajnimeve.

XII. Trajnimi i anëtarëve të KZAZ-ve, KQV-ve , GNV-ve

1. Trajnimi i drejtpërdrejtë (fizik) i administratës zgjedhore është metoda që synon KQZ.
2. Në rastet e pamundësisë së kryerjes së trajnimit të drejtpërdrejtë, për shkak të pandemisë apo për ndonjë shkak tjetër evident, trajneri, njofton KQZ.

3. DAZ organizon trajnimin vetë përmes platformës online Zoom/ose ekuivalente me të.
4. Programi i trajnimit të anëtarëve të KZAZ & GNV, do të zhvillohet në ambientet që do të zhvillohet trajnimi i parë i KZAZ-ve dhe sipas rastit në VNV.
5. Për realizimin e trajnimit, secili trajner do të ketë bazën materiale trajnuese didaktike dhe logjistike, sipas planifikimit në skemën e trajnimit të anëtarëve të KZAZ-së, KQV-së dhe GNV-së.


XIII. Kalendari i trajnimeve

Kalendari i trajnimeve për administratën zgjedhore dhe planifikimi i realizimit të tyre është respektivisht sipas lidhjes 1, bashkëlidhur këtij programi.

Planifikimi i trajnimeve të tjera bëhet nga DSZMFM.

Lidhja 1 Planifikimi i realizimit të trajnimeve të administratës zgjedhore

Trajnimi	Trajnues të angazhuar	Koha e realizimit të trajnimit	Nr komisionerëve zgjedhor që do të trajnohen	Nr. Ditëve që do të trajnohet trajnuesi (ToT)	Nr. Ditëve që do të trajnojë secili trajnues
Trajnimi i kandidatëve për trajnerë (afatgjatë)	39	06 - 31 (Janar, 2023)		3 grupe x 13 pjesmarrës (4 ditë secili grup)	
Trajnimi i kandidatëve për trajnerë (afatshkurtër)	39	03-20 (Janar, 2023)		3 grupe x 13 pjesmarrës (2 ditë secili grup)	
Trajnimi i anëtarëve të KZAZ-ve (Procesin e regjistrimit të kandidatëve)	39	16 - 20 (Shkurt 2023)			1 - 2 ditë
Trajnimi i anëtarëve të KZAZ-ve (Pjesa e dytë)	39	12 - 20 (Prill 2023)	736		1 - 2 ditë
Trajnimi i anëtarëve të KZAZ-ve (për zëvendësimet)	39	25 Prill - 10 Maj 2023	Sipas nevojës		1 ditë
Trajnimi i anëtarëve të KQV-ve përfshirë vlerësimin e tyre nga trajnerët	78	25 Prill - 13 Maj, 2023	25995 komisionerë		9 - 11 ditë
Trajnimi i kryetar + sekretar të KQV-ve përfshirë vlerësimin	78	08 - 11 (Maj 2023)	10398 komisionerë		2 - 4 ditë
Trajnimi i anëtarëve të GNV-ve	92	04-14 (Maj 2023)	3416		3 ditë



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS ZGJEDHORE

Data 17.02.2023

Nr. 922/1 Prot.

NDREQJE GABIMI

Në vendimin 218, datë 01.12.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve bëhet korrigjimi si më poshtë:

Është:

"Kohëzgjatja e trajnimit do të jetë 2 orë për anëtarët e KZAZ, GNV apo KQV ndërsa për kryetarë dhe sekretarë të KQV-ve 4 orë."

Bëhet:

"Kohëzgjatja e trajnimit do të jetë 2 orë për anëtarët e GNV apo KQV ndërsa për KZAZ dhe kryetarë dhe sekretarë të KQV-ve 4 orë."